



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 7 Prot.

Tiranë, më 13/05/2020

VENDIM
Nr. 5 datë 13.05.2020

PËR
NGRITJEN E KZF DHE PËRCAKTIMIT TË NUMRIT TË ANTARËVE TË KZF, NE
NJËSITË KRYESORE TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

Në bazë të nenit 6, 7 e në vijim të Rregullores së Zgjedhjeve miratuar nga Senati Akademik i UMT-së me Vendimin nr.13, datë 12.02.2020 “Për miratimin e Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, sot më datë 13.05.2020 Komisioni Institucional Zgjedhor,

VENDOSI:

Ngritjen e Komisionit të Zgjedhjeve në Fakultete të UMT, me përbërjen si më poshtë:

1. Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Mjekësisë, përbëhet nga 9 anëtarë, nga të cilët 1 (një) është përfaqësues i studentëve. Pranë KZF caktohet dhe sekretari i KZF, pa të drejtë vote.
2. Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Mjekësisë Dentare, përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët 1 (një) është përfaqësues i studentëve. Pranë KZF caktohet dhe sekretari i KZF, pa të drejtë vote.
3. Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, përbëhet nga 7 anëtarë, nga të cilët 1 (një) është përfaqësues i studentëve. Pranë KZF caktohet dhe sekretari i KZF, pa të drejtë vote.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, afishohet në ambientet e UMT-së dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së, si dhe përcillet për zbatim njësive kryesore dhe strukturave përgjegjëse të UMT.

KRYETAR
SILVANA BALA